



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.905/1 prot.

Tiranë më 16.5.2023

Lënda: Mendim mbi projektligjin *“Për sigurinë kibernetike”*.

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*), ka administruar shkresën tuaj nr. 2089 prot., datë 08.05.2023, me anë të së cilës dërgohet për mendim projektligji *“Për sigurinë kibernetike”*, si dhe dokumentet shoqëruese.

Nga shqyrtimi i këtij projektligji, Zyra e Komisionerit vëren se ky akt synon të jetë i harmonizuar plotësisht me legjislacionin Evropian në këtë fushë dhe ka për qëllim të përmirësojë kornizën aktuale ligjore të sigurisë kibernetike, me qëllim arritjen e një niveli të lartë sigurie në nivel kombëtar.

Referuar dokumenteve shoqëruese (Relacion dhe Tabelë përputhshmërie, bashkëlidhur shkresës suaj), vërejmë se projektligji është hartuar duke u përafëruar plotësisht me Direktivën (BE) 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 6 korrik 2016 *“Në lidhje me masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në të gjithë Bashkimin Evropian”*.

Në vijim, nga shqyrtimi i nivelit të përputhshmërisë së neneve, në të cilat parashikohet mbrojtja e të dhënave personale, konstatojmë se niveli i përafërimit i referohet përputhshmërisë me Direktivën 95/46/EC të Bashkimit Evropian. Bëjmë me dije se Direktiva 95/46/EC është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 27 prill 2016 *“Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/KE”*.

Sikurse jeni në dijeni, me mbështetjen e ekspertëve të projektit të binjakëzimit që asistuan në këtë proces, Zyra e Komisionerit ka përgatitur draftin e projektligjit *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i përafëruar me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) dhe Direktivën e Policisë, i cili pritet të miratohet së shpejti.

Në këtë këndvështrim, vlerësojmë se hartimi i projektligjit “Për sigurinë kibernetike” duhet vlerësuar në harmoni me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i cili është në fazën e vlerësimit përfundimtar për t’u përcjellë në qeveri për miratim), pasi ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe përbën një zhvillim konkret në procesin e integritetit të vendit.

Vlen të theksojmë se, nga përmbajtja e projektligjit “Për sigurinë kibernetike” në tërësi, implementohen parimet dhe rregullat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Megjithatë, do të kërkonim nga ana juaj marrjen në konsideratë të sugjerimit të mëposhtëm.

Në pikën 3, të nenit 27 të projektligjit, sugjerojmë të shtohet germa “c”, me përmbajtje:

“Autoriteti bashkëpunon me autoritetin kombëtar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, në rastet kur trajtohen incidente të cilat rezultojnë në përhapje të paligjshme të të dhënave personale”.

Sugjerimi bazohet gjithashtu edhe në referencë të parashikimit të pikës 4, të nenit 16 të Direktivës (BE) 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Me përfshirjen e sa më sipër, projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi